



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna e Kaçanikut**  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 13733/24  
Kaçanik, 19.06.2024

## PROCESVERBAL

Nga Dëgjimi publik me qytetarë -Administratorë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, OJQ, Përfaqësues të shkollave dhe grupe tjera të interesit, organizuar nga Kryesuesi i KK në bashkëpunim me KPF. Dëgjimi publik u mbajt në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00. Evidenca e pjesëmarrësve është si në listën e bashkëngjitur (Administratorë të fshatrave, anëtarë të KK, anëtar nga ekzekutivi, zyrtar komunal).

Dëgjimin publik e kryesoj Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,

Procesmbajtëse Mavije Murseli.

### **Tema: Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2025-2027**

**Kryesues i Kuvendit :** Lidhur me pjesëmarrjen në debate publike, nuk jemi të kënaqur kur po organizojmë debate publike. Ne si Kuvend e kemi përherë të parë me insistimin e KDI-së për shkak grantit të performancës sepse zakonisht ekzekutivi ka mbajt dëgjime publike sa i për këtë Kornizës Afatmesme Buxhetore, ne e kemi mbajt në muajin Shtator si Kuvend kur është miratua buxheti, por sidoqetëjetë me insistimin e KDI-së edhe ne si Kuvend bashkë me anëtarët e KPF-së kemi insistua të organizojmë debat publik rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore i cili është një dokument i cili përcakton në vija trasha por që mund të pësojë ndryshime deri në miratim buxhetit. Burimet financimit dhe tendencat e shpenzimeve që do të bëjë komuna gjatë vitit 2025 dhe parashikimet për vitin 2026, 2027, para vetes e keni vetëm listën e projekteve kapitale ndërsa si dokument i tërësishëm ka qenë i publikuar në ueb faqe të komunës, kush ka qenë i interesuar e ka pasur mundësin ta shfletoj dhe të shohë. Kur po flasim për buxhetin ne po fokusohemi vetëm te investimet kapitale ndërsa buxheti ka të bëjë edhe me gjera tjera, ka të bëjë me shqyrtimet komunale, ka të bëjë edhe me subvencione dhe transfere edhe pak në debate publike thirrret për këto tema ndërsa gjithë fokusi orientohet te investimet kapitale ndërsa një kategori hiq me pak të rëndësishme janë subvencionet që ndodhen në fusha të ndryshme. Sa i për këtë buxhetit dhe vlerave të buxhetit është drejtori këtu por fillimisht nënkryetari e kërkon fjalën si për fillim mandej edhe drejtori dhe e hapim diskutimin.

**z.Sabedin Vishi – Nënkrjetar i Komunës :** Faleminderit Kryesues, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar administrator dhe gjithë ju të pranishëm, mirë se keni ardhur në takim in e parë të debatit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, siç po e shini ju para vetes e keni buxhetin për vitin 2025, i cili do të jetë 12,592,238.00 €. Kemi një rritje nga viti i kaluar 5.30%, apo me vlerë monetare 633,255.00 €, kategoritë ekonomike këto të ndara janë në rritje të buxhetit po ashtu e kemi edhe listën e projekteve kapitale, presim nga ju projekte apo propozime të reja qe janë me prioritet dhe për këtë janë shumë rëndësishme dëgjimet publike me qytetarët ku fatkeqësisht edhe këtë vit ka mungesë të qytetareve në përgjithësi andaj mbasi të projektohet buxheti na e kemi problem me shti ndonjë projekt qe është me prioritet. Unë nuk besoj qe ka nevojë me hy në detaje sepse është drejtori i Buxhetit qe merr fjalën por sot është fjala edhe juaja me dhënë ndonjë propozim apo a jeni të kënaqët me shpërndarjen fillestare të buxhetit, kjo nuk domethënë që është përfundimtare sidomos tek lista e projekteve kapitale për vitin 2025, pajtohem plotësisht me Kryesuesin që potencoj hiq më pak të rëndësishme janë subvencionet .

**Kryesues i Kuvendit :** E hapim diskutimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komonale për vitin 2025-2027.

**znj.Ardita Rrahmani :** Pavarësisht praktikave të më hershme që kanë qenë, kjo është mirë qe po diskutohet, gjithsesi kemi me diskutua edhe në Komitet për Politik dhe Financa që anëtarët e tjerë të komitetit nuk janë prezent dhe mungesa e tyre nuk do të ketë kurrfarë arsytimi sepse jemi ne ata personat e parë që kemi me u ballafaqua. Duke i parë propozimet të projekteve kapitale 2025-2027, pavarësisht asaj si Arditi që flas në Kuvend Komunal dhe kundrejt kërkesave të cilat unë i kam edhe i paraqes po e shoh qe këtu nuk janë paraparë asnjë d.m.th. ajo çka flas unë në Kuvend përveç shënimeve që merren për procesverbal kurrgjë konkrete nuk ka, nuk e di se a ka përfaqësues të fshatit Stagovë këtu, unë banoj në atë pjesë rrugës për te varrezat e reja të qytetit, ata që e din dhe që kalojnë atë rrugë e din se sa problematike është mungesa fillimisht e ndriçimit, nuk është qe nuk është diskutuar përveç mungesës së ndriçimit është edhe mungesa e trotuarit me kaluar këtë kohë andej është sikur në korz sepse ka qytetarë që frekuentojnë shumë atë pjesë, aksidentet janë po thuajse çdo ditë për këtë mundeni me bisedu edhe me Policin e Kosovës. Përveç aksidenteve problematike tjetër për kalimtarët janë edhe ngacmimet e shumta duke marrë parasysh qe aty nuk ka as kamera as ndriçim, siç e potencova kjo është e kërkesa e parë çka e kërkoj nga Shërbimet Publike. Tek Zhvillimi Ekonomik parashihet ndërtimi i kioskave për biznese në Bulevard dhe në sheshin e qytetit, si dhe në pikat e tjera turistike, nuk mendoj qe është keq por le të jetë si kritik hapësirat publike me ndërtimin e kioskave siç është bërë në kaluarën rreth korzes.

Në pikën 29 tek Planifikimi Urban dhe Mjedisi është ndërtimi i urave në lumin Lepenc ku janë ndarë një shumë prej 200.000.00 €, shumë e cila ka me u realizua në vitet 2025 -2027, kisha dashur ta dija konkretisht ku parashihen këto ura?

Çështja tjetër është lidhur me arsimin fillor, edhe kjo është një diçka për të cilën e diskutoj çdo seancë për arsye se është një problematik e madhe e shkollës fillore "Emin Duraku", e di qe nuk është realizim i cili bëhet prej komunës por kur fillon digjitalizimi e objekti kundërvënë edhe është aq i vjetër.

Urojë që këto projekte kapitale të cilat janë parapare për vitin 2025-2027, të jenë në harmoni të plotë me kërkesat e qytetareve për arsye se tërthorazi dëgjova që kërkesat e tyre nuk janë paraparë këtu.

**Kryesues i Kuvendit :** Limitet buxhetore janë ato të cilat kufizojnë mundësin e investimeve, sepse po të kishim buxhet ma të madh sigurisht që edhe kërkesat duhet plotësoheshin më shumë. Këtu kanë qenë ata të cilat janë ma me prioritet sipas drejtorisë dhe Kryetarit sepse Kryetari i vendos propozimet por megjithatë ka mundësi që ndokujt ndonjë prioritet i ka mbetur anash dhe ka hy ndonjë prioritet tjetër, prandaj organizohen debate dhe këto diskutime që në fund kur të miratohet buxheti në muajin Shtator të kemi mundësi që të nxjerrim atë që është ma e mira e mundshme për ato, sepse është e pamundur me u plotësua gjitha kërkesat.

Ne duhet të kalkulojmë dhe të lëvizim me aq buxhet sa kemi dhe duhet përfshijmë kërkesat të cilat mund ti mbulojmë me buxhetin sa e kemi, mendoj që për këtë Kryetari ka menduar dhe e ka sjell si draft të parë Kornizën Afatmesme Buxhetore pastaj janë dhe disa hapa për buxhetin të cilat e plotësojnë këtë debat publik dhe fund është miratimi i buxhetit cili është final në të cilin duhet përfshihen pak ato që janë me prioritet dhe ma të rëndësishme.

**z.Bahri Selimi :** Çështja e shkollës "Emin Duraku", është shqetësim i të gjithëve, mirëpo ndërtimi i objektit të shkollës parashihet për këtë vit dhe është obligim i Ministrisë së Arsimit. Ne i kemi paraparë mjetet për digjitalizim e shkollave fillore dhe shkollave të mesme, mirëpo për vitin 2026, dhe jo për vitin 2025 sepse nuk ka pas mundësi buxhetore, por edhe kjo mbetet mbasi të ndërtohet shkolla e re apo plotësimi i detyrave nga ministria, madje ne me filluar me procesin e digjitalizimit. Na po presim këtë vit, prej drejtorit të Arsimit dhe i kemi gati të përfunduar debatet që i ka zhvillu në ministri dhe po pritet shumë shpejt të realizohet kjo.

**z.Sabedin Vishi – Nënkryetar i Komunës :** Ne kemi me filluar me procesin e digjitalizimit dhe kemi filluar me shkollën "Emin Duraku". Është një numër i madh i nxënësve dhe një numër i madh i klasave, kjo ka qenë prioritet i qeveris ku edhe nëpër shkolla i kemi pajisur me nga një tabelë digjitale varësisht prej numrit nxënësve, ka qenë paraprakisht me u përgatit edhe arsimtarët dhe nxënësit për teknologjinë ma të rejë dhe si prioritet e kemi digjitalizimin e shkollave.

Sa ai përketë shkollës "Emin Duraku", dje e ka dërguar shkresën e fundit drejtori i Arsimit që kanë kërkuar prej ministrisë dhe pritet me ja fillua shkollës fillore "Emin Duraku".

Trotuari që shkon te varrezat është kërkesë shumë me vend, por besoj që je pajtua që ka pasur probleme kryesore aty për atë arsye ka mbetur ashtu deri tash. Ndërsa çështja ndriçimit besoj që është si kodë dhe janë mjetet e ndara për këtë. Kioskat në shesh kemi llogarit me i financua vet dhe me qenë të njëjta dhe jo me kanë laramani siç kanë qenë deri me tani dhe jo numër i madh. Në shesh ka me qenë e projektuar që me pas një arkitekturë të mirë.

Për urat mbi lumin Lepenc janë të ndara mjetet ne vlerë prej 200.000.00€, kemi me filluar nga ura Biçecit dhe Nikaj sepse është një prej urave ma të ngushta që është deri tash.

**z.Ibrahim Dalloshi – përfaqësues i f. Soponicë :** Në pjesën ku jetojmë na kemi pasur problem me një ambulant, tash e kemi hapur por tani kemi disa probleme tjera, një punëtorë ndihmës është larguar nga vendi i punës, një rëntgen na mungon dhe një automjet. Meqenëse kemi pasur një rast helmimi në fshatin Doganaj, ku edhe janë helmuar shumë persona dhe unë kam biseduar konkretisht me drejtorin dhe kam kërkuar që së paku ajo ditë që nuk punohet, të punojnë për shkak të helmimit të madh që ka qenë, por një gjë e tillë nuk është realizuar fare.

Shkolla në fshatin Doganaj ka mbetur pa u ndërtuar, nuk e di se ku është faji a është i ministrisë apo i komunës.

Një fushë sporti e kemi kërkuar bashkëpunim me fshatin Doganaj dhe ajo nuk është realizuar. Çështja e ujësjes në këtë kohë kemi mungesë të madhe po thuajse që katër ditë jemi pa ujë të pijshëm.

**z.Hasip Salihu - përfaqësues i f. Bajnicë :** Po e shohë listën e projekteve kapitale për vitin 2025-2027, mirëpo kërkoj që të gjitha këto të hynë në vitin 2024, asfaltimi i rrugicave me të vërtetë ja vlen sepse në një rrugicë jetojnë mbi 15 familje, po ashtu vazhdimi i përroskës për të cilin jam konsultuar edhe me drejtorin sepse rrezikohet uji i pijshëm, si dhe ndriçimi nëpër disa rrugica, pra të gjitha këta janë kërkesat për fshatin Bajnicë.

**z.Naser Murseli – përfaqësues i f. Doganaj :** Unë i kam disa kërkesa të vogla të cilat janë me prioritet, kanalizimi dhe kanali i ujitjes që keni bërë e dini të gjithë që ujë nuk ka, unë kam insistuar edhe vitin e kaluar, po thujse që dy vite uji nuk hyn hiq dhe për 80 metra është në pyetje. Duke investuar 800 metra kanal dhe ujë mos me pas kjo është absurde, nuk e di ku është faji por faji është jetim gjithmonë.

Ndriçimi në lagjen Dedë dhe Lekë janë lagje të mëdha të cilët kanë nevojë për ndriçim, po ashtu shkolla fillore në fshatin Doganaj është mjerim 5 vite i ka bërë, parat janë ndarë vjet dhe asnjë investim nuk e ka bërë kontraktori, prapë edhe këtë vitë janë ndarë parat përsëri asnjë investim, shkolla ka filluar me u dëmtuar si dhe 300 nxënës zhvillojnë mësimin dhe qëndrimin nëpër insekte të ndryshme.

**z.Fatmir Bunajku :** Kërkoj një sqarim, te ura e Nikajve dhe Biçecit çfarë forme do të ketë ura?

**z.Qamil Stagova :** Për vitin e ardhshëm është paraparë ura në fshatin Nikaj dhe Biçec kanë me qenë forma rregullta nëpërmjet zyrës prokurimit.

**z.Sabedin Vishi – Nënkryetar i Komunës :** Te ura Nikaj, Biçec, ajo shkon me standarde evropiane, ura bëhet më e madhe dhe hiqet ekzistuesja .

Shkolla fillore në Doganaj që është një pyetje e përbashkët e z.Ibrahimit dhe z.Naserit, ne kemi mbetur shumë keq si Komunë për shkollën në Doganaj, ajo është nisur në vitin 2019 dhe ka qenë dashur me u përfunduar 2022 d.m.th. është e kontraktuar dhe është komplet prej qeveris ku as procedura prokurimit nuk kemi pasur ne si komunë po as menaxher të projektit, d.m.th. me dokumente e projektim me prokurim dhe proceduara janë të ministrisë, tash faji a është te ministria apo te kompania na nuk kemi qasje, me dal me analizuar ne jemi tu nda pare për shkollën e "Voskopojës" dhe për të gjitha shkollat, ndoshta ka qenë dashur më mirë vetë me e nisur shkollën fillore në Doganaj po përderisa kemi kontratë për momentin kjo është thikë me dy teha, por nëse e nis ti thjesht e ke pasur kontratën por ti po do me dëmtuar buxhetin te pasur prej nivelit qendror e për neglizhencë ju e dini i ka thirrur me media po ashtu edhe kur kanë pasur probleme me insektet krimbat të cilët po dalin po ashtu i kemi dërguar edhe me email të Kryetarit direkt ministrit por asnjëherë nuk kemi pasur asnjë përgjigje, tash po besoj që fajin po e kuptoni se kush e ka .

Ndriçimi nëpër lagje nuk hyn si komunë, ku ka nëpër lagje ndriçim e kanë bërë me investim vetanak por mirëmbajtjen shpenzimet i ka hekë komuna.

Te ujësjellësi, po çuditë sepse realisht tani është me pagesë, e dini që menaxhimin e ka Bifurkacioni, moment që po ndalet uji direkt e thërrasin Kryetarin, krejt çka mundemi me bë ne me thirr Shefin e Bifurkacionit dhe me i thënë keni defekt në Doganaj d.m.th. për menaxhimin e brendshëm të Bifurkacionit të ujësjellësit në moment që e merr në menaxhim nuk kemi qasje na si komunë, përpos që moralisht me thirr dhe me ju thënë se janë duke pasur probleme për ujë, ka keq menaxhim të Bifurkacionit

Te kanali i ujitjes në Doganaj, këtë po e dëgjoj për herë të parë që kem investuar vitin e kaluar për 80 metra mirëpo tani drejtori jep sqarime më shumë.

Bajnicë, te asfaltimi i rrugicave besoj se këtë vit, vazhdimi i përroskës, paske folur direkt me drejtorin besoj qe e keni biseduar se a ka mundësi apo jo.

Për terenet sportive ne i kemi ndarë 100.000.00€ për terene jashtme për vitin e ardhshëm, ne jemi tu mundu dhe nuk domethënë qe kemi me qëlluar më të mirën mundëshme por jemi tu mundu, ato që kanë terene të brendshme të shkollave dhe fshatrave nuk jemi tu hi në ato fshatra, por jemi tu shkuar aty ku nuk kanë as teren sportiv të jashtëm dhe brendshëm. Këtë vit një teren të jashtëm në fshatin Gllaboçicë nuk kemi shkuar në bazë numrit të banoreve por në bazë të largësisë sepse një grup i të rinjve në qoftëse bëjnë një termin të futbollit katër vetura ju duhen me ardh deri në Kaçanik, Ferizaj apo Tetovë, minimumi 60 euro veç nafta e lere më fusha dhe shpenzimet e tjera, andaj e kemi parë të arsyeshme për këtë vit, ndërsa për vitin e ardhshëm janë 100.000.00€ sigurisht qe i dëgjojmë propozimet e juve dhe në fund bashkërisht vendosim nuk domethënë qe kërkesat e juve janë të paarsyeshme, të gjitha janë të arsyeshme por gjithmonë në përputhje me buxhetin që kemi.

Te rentgeni dhe automjeti ja japim fjalën drejtorit Shëndetësisë z. Malsiut.

**z. Fatmir Bunjaku :** Unë fillimisht dëshirojë ta falënderojë nënkryetarin për iniciativën për trotuarin dhe ndriçimin e lagjeve Shorr, Gavaz dhe Bektesh , se me të vërtet ka nevojë për shkak se qarkullojnë shumë nxënësit andaj kam edhe një kërkesë për ndriçim te lagjet Koraq,Mezin dhe Bunjak, është me një gjatësi mbi 1 km dhe është shumë me rëndësi realizimi i saj për shkak se edhe këtu qarkullojnë nxënësit.

**z.Azem Koraqi - përfaqësues i f. Koraq :** Kërkesë e lagjes Koraqeve, është rregullimi dhe vazhdimi i përroskës dhe në lagjen Trupajve mburoja me hekur për shkak se gjatë kohës së dimrit është shumë rrezik, po ashtu në lagjen Muqeve të bëhet rregullimi i kanalizimit.

**z.Sali Malsiu :** Sa i përketë pyetjeve rreth QMF-së, në Doganaj, punëtorja ndihmëse është pranuar me konkurs dhe është duke punuar aty. Ndërsa sa i përketë rëntgenit dhe veturës së ambulantes me qëndrua aty është kërkesë e arsyeshme, po për shkak numrit vogël të punëtorëve qe kemi, sidomos kërkesa për shofer dhe rëntgen për momentin nuk mund të realizohet në këtë periudhë kohore. Sigurisht ne si fokus e kemi me bërë me dy ndërrime dhe ka qenë prioritet i QMF-së Doganaj.

Në QMF Doganaj çdo ditë qytetaret marrin shërbime. Te laboratorit janë duke u kryer shërbime, kemi arrit me bërë një kontratë për me i përmbush gjitha llojet e analizave.

**z.Sabedin Vishi – Nënkyetar i Komunës :** Te përroska e Koraqeve një pjesë është goxha e rregulluar, ne e kemi kodin qe e kemi për përroska, drejtori z.Qamil e bën kërkesën varësisht prej prioriteteve sepse na vazhdimisht jemi duke punuar por a jemi duke ja qëlluar saktësisht mbetet të shihet, te lagjja e Trupajve mburoja me hekur kërkesë me vend po e shkruaj këtu, ndërsa rreth kanalizimit të lagjes drejtori z.Ramadush ju jep sqarime edhe te lagjja e Muqeve.

**z.Ramadush Osmani :** Kemi regjistruar shumicën e kërkesave qe kanë të bëjnë me degëzime sekondare, mirëpo ne e kemi kodin ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe aktualisht është në fazën e tenderimit me një kontratë dy vjeçare në vlerë financiare prej 200.000.00 €, gjithashtu e kemi edhe listën e prioriteteve dhe do të intervenojmë në të gjitha lokalitetet.

Procesmbajtës  
Mavije Murseli



Kryesuesi i Kuvendit  
Kental Murseli

